



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik  
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-1946/2018  
Kaçanik, 24.01.2018

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e I (Parë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik (Legjislatura e VI-të), mbajtur më datë 24 Janar 2018.. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarët, pjesëmarrës në mbledhje ishin 27 anëtarë- të gjithë anëtarët.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Nënkyretari i Komunës –Ylber Bajra, drejtorët e drejtive komunale: Bahri Selimi, Diana Reka, Fatmir Loku, Festim Neziraj, Zahir Doda, Ukshin Qallaku dhe Ramadush Osmani.

Nga Mbledhje morën pjesë edhe zyrtarët: Fatlume Guri- zyrtare për informim, Bejtulla Dalloshi, zyrtar i IT.

Mbledhja u monitorua përmes Teleprezences nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të KK në MAPL

Nga OSBE- mbledhjen e monitoroj, Faruk Dërmaku.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli,** Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari i përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, kuorumi ekziston me u mbajtur mbledhja, kushte pune ka, andaj e hapi mbledhjen e I (Parë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2018, data; 24 Janar, me këtë:

### REND PUNE

1. Propozim Plani i Punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2018;
2. Aprovimi i Prosesverbalit nga Mbledhja Konstitutive e Kuvendit të Komunës;
3. Propozim Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
4. Propozim Vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete;
5. Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2018;
6. Propozim Vendimi për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB);
7. Propozim Vendimi për lejimin e mjeteve financiare, për realizimin e projekteve të Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës;
8. Propozim Vendimi për lejimin e mjeteve financiare, për realizimin e projekteve të Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
9. Informatë e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor, 2017/2018;
10. Informatë për përfornancën e Komunës për vitin 2016.

Arsyeja pse është pikë e parë, Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018, është se Plani është dashur të aprovohet në fund të vitit 2017. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin; Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë, Rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për këtë Rend Pune. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës , e ;

### APROVOJ

#### **Rendin e Punës në Përbërje 10 pikave.**

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas radhës:

1. Propozim Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Materialin e keni marrë, disa pika në këtë Plan pune janë të rregullta, ndërkaq të tjerat janë futur në plan në bazë të propozimeve të ekzekutivit të komunës. Nëse ka kush diçka, për këtë pikë e hapi diskutimin:

**znj. Nazife Krasniqi,** Propozoj në Plani e punës së KK të shtohet numri i mbledhjeve për Komitetin për Komunitete si dhe shtimin e buxhetit për kompensimin e këtyre dy mbledhjeve. Arsyeja; ka shumë çështje që bien në kompetenca të kësaj trupe punuese dhe kujtoj se është vështirë me i përmbledhur të gjitha këto çështje me vetëm me 4 mbledhje të këtij komiteti.

**z. Selim Reka,** Propozoj që në hartimin e Planit të Punës së KK, për hera të tjera të përfshihet edhe opozita, ashtu si është punuar në vitet tjera, ndërkaq kërkoj që në një mbledhje të gjashtëmujorit të parë të vitit 2018, të hynë pikë e rendit të punës; Informata e DAK përfundimin e vitit shkollor 2017/2018.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Të çështja që e ngriti znj. Krasniqi, ky Plan pune është bërë me buxhetin e komunës 2018, ndërkaq ne do t'i shqyrtojmë mundësitë se çka mund të bëjmë me Rishikim buxhetor 2018.

**z. Ekrem Raka,** Së pari u përgëzoj për hartimin e Planit të punës së KK për vitin 2018, ndërkaq nga të dhënët në pjesën buxhetore të këtij plani, shihet se buxheti i aprovuar për Kuvendin e Komunës -organin me të lartë të komunës është shumë i ulët. Këtë çështje duhet ta kemi në konsideratë me Rishikim buxhetor 2018, buxheti në këtë sektor të rritet. Të pika 9 e planit, ku shënohet, mediat publike, fjala “publike” duhet të hiqet.

**z. Kemal Mërseli,** Edhe unë jam për atë që në të ardhmen, me Rishikim buxhetor do të shqyrtojmë mundësitë me bërë ndryshime buxhetore në sektor të caktuar. Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë me vërejtjet të cilat u dhanë, Planin e Punës së KK për vitin 2018 e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

### VENDIM

#### **Për Aprovimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018.**

2. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja Inauguruese e Kuvendit të Komunës;

Procesverbal i mbledhjes së kaluar të Kuvendit të Komunës aprovua njëzëri pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi së, Kuvendi i Komunës e,

**APROVOJ,**

**Procesverbalin e mbledhjes Inauguruese të Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 20 Dhjetor 2017 / Lënda: 01Nr. 60/01-40373/2017.**

**Kryesuesi i Kuvendit**, pas Procesverbalit, atëherë nëse ka kush ndonjë pyetje apo kërkesë, atëherë kalojmë në pozicionin:

**PYETJE dhe KËRKESA**

**znj. Nazife Krasniqi**, Kérkoj nga Kryetari i Komunës, që në këtë mandat të cilin e ka marrë, të përfshijë femra në Kabinetin e tij qeveritar.

**z. Ekrem Raka,**

1. Kérkoj përgjigje me shkrim, a do të rregullohet salla e kuvendit me inventar të nevojshëm dhe renditje ashtu siç e kérkon rendi, sepse kjo sallë kështu si është nuk i plotëson kushtet për mbledhje të KK.

2. Kérkoj të pajisemi me infrastrukturë ligjore, me theks të veçantë, me të pajisemi më kopje fizike të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

**z. Shpend Krusha**, Shprehi shqetësimet e tija për gjendjen e vështirë të një familje në f. Sllatinë, për të cilën gjendje tha së janë të informuar, Kryetari i Komunës dhe drejtoresha e DSHMS, Diana Reka. Kérkoj me pas një përkujdesje ndaj kësaj familje si institucion dhe nëse ka nevojë mund të formohet një Komision nga KK, me i bërë një vizitë familjes në fjalë.

**z. Selim Reka**, Kérkoj të sigurohet një drenazhë për vendosjen e kufomës të varrezat e qytetit në Kaçanik, në mënyrë të bëhet varrimi i të vdekurve ashtu siç e kérkon rendi e rregullat.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Salla e kuvendit e dimë se nuk është e përshtatshme për debate kështu si është. Çështja se çka mundemi me bërë, nuk mund të themi tanë, sepse është në pyetje buxheti. Të çështja e infrastrukturës së nevojshme ligjore, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, ky ligj do t'iu ofrohet nga Shërbimi i Kuvendit. Edhe për Kérkesat të tjera, besoj do të merrni përgjigje në mbledhjen vijuese të KK.

3. Propozim Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Unë e kam pasur një takim konsultativ me, Shefat e grupeve parlamentare për çështjen e formimit të komiteteve obliguese të KK. Në bazë të LVL, Komiteti për Politikë dhe Financa në komunën tonë përfaqësohet me, 7 anëtarë. Sipas formulës së llogaritur, 3 anëtarë nga PDK, 1 anëtar nga LVV, 1 anëtar nga LDK dhe 1 anëtar nga NISMA. Fillimisht kérkoj t'i prezantoni, Shefat e grupeve parlamentare.

**zpj. Lirije Luta**, Subjekti politik i Partisë Demokratike të Kosovës- PDK, për, Shef të grupit parlamentar është caktuar, **Nexhat Luku**.

**z. Shpend Krusha**, Nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje-LVV, është caktuar për, Shef grupi parlamentar, **Ekrem Kyçyku**.

**znj. Arlinda Rakoci –Raka**, nga Lidhja Demokratike e Kosovës-LDK, Shef i grupit parlamentar është caktuar, **Selim Reka**.

**z. Hajredin Luta**, Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Shef i grupit parlamentar është caktuar, **Shemsedin Luzha**.

**znj. Hafize Sallahi**, Nga subjekti politik NISMA për Kosovën -NISMA, Shef grupi parlamentar është caktuar, **Bekim Koxha**.

**z. Ekrem Raka**, Për hir të korrektësisë, edhe pse nuk u kërkua të prononcohem nga, IQ Lista për Kaçanikun për çështjen e shefave të grupit parlamentar, ndërkaq shtoj se në një takim konsultativ me Kryesuesin e Kuvendit, ia kemi bërë të ditur Kryesuesit të Kuvendit, Kemal Mërseli, se sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL) Komiteti për Politikë dhe Financa duhet të jetë gjithëpërfshirës nga të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në KK, ndërkaq në vazhdim z. Raka i lexoj nenet e LVL dhe të Udhëzimit Administrativ që e rregullojnë çështjen e formimit të Komitetit për Politikë dhe Financa.

**z. Ekrem Kyçyku**, Unë e përkrahi propozimin e Ekrem Raka, sepse kjo është bërë në disa komuna. Ne si Lëvizje Vetëvendosje pa e marrë miratimin nga MAPL, nuk do të japim propozim konkret për përfaqësimin e këtij subjekti politik në KPF.

**z. Kemal Mërseli**, Shumica në Kuvend e përfaqëson edhe shumicën në KPF. Dispozita ligjore e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, e qartëson mirë formulën për përfaqësim në KPF. Unë e kam bërë llogaritjen e formulës dhe nuk ka kurrfarë dileme në këtë drejtim.

**z. Selim Reka**, Propozimi i Ekrem Raka është plotësish me vend ashtu që në KPF të ketë gjithëpërfshirje të subjekteve politike të përfaqësuara në KK. Kështu edhe subjekti i LDK nuk do të jap përfaqësuesin e saj në KPF pa u përfshirë, IQ Lista për Kaçanikun.

**z. Kemal Mërseli**, Nëse ne do të vepronim në kundërshtim me ligjin, atëherë MAPL na e kthen vendimin. Kërkoj nga subjekti politik i PDK të dal me propozime për përfaqësim në KPF.

**z. Nexhat Loku**, Nuk është faji i PDK që e ka shumicën në Kuvendin e Komunës, 11 anëtarë.

**z. Hamid Guri**, Në emër të grupit parlamentar të PDK, për anëtarë të KPF, propozoj:

1. Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, sipas detyrës zyrtare, e kryeson edhe KPF,
2. Nexhat Loku dhe
3. Pranvera Loku-Zharku.

Nga LVL, Ekrem Kyçyku, Theksoj se nuk japim propozim, për arsyet e theksuara.

Nga LDK, Selim Reka, Theksoj se edhe ky subjekt politik nuk do të jap propozim për arsyet e cekura me herët.

**z. Shemsedin Luzha**, Nga AAK, për anëtar në KPF, e propozoj të emërohet, Hajredin Luta.

**z. Bekim Koxha,** Nga subjekti politik NISMA, e propozoj për anëtar të KPF, Hafize Sallahi.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Për mua ligjshmëria është krejt në rregull, unë nuk kurrfarë arsy me kërkua shqyrtimin e ligjshmërisë në MAPL për këtë rast. Ato subjekte politike që kanë dilema në këtë aspekt, është e drejtë e tyre me kërkuar shqyrtimin e ligjshmërisë në MAPL. Në vazhdim, propozimet që dolën u shtruan në votim për aprovim dhe u miratuan me 17 votë Për, Kundër ishin 10 anëtarë., Abstenim nuk pati. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë ;

#### VENDIM

**Për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, në përbërje, 7 anëtarë, me përfaqësimin si vijon:**

	PDK	Kryesues sipas funksionit
1. Kemal Mërseli	PDK	anëtar,
2. Nexhat Loku	PDK	anëtar,
3. Pranverë Loku-Zharku	PDK	anëtar,
4. _____	LVV	anëtar,
5. _____	LDK	anëtar,
6. Hajredin Luta	AAK	anëtar, dhe
7. Hafize Sallahi	NISMA	anëtar.

Emrat e dy anëtarëve nga LVV dhe LDK, do të plotësohen, pasi t'i propozojnë dy subjektet politikë që janë të përfaqësuara në KPF.

#### 4. Propozim Vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Ky komitet kam propozuar të jetë në përbërje 5 anëtarë, kështu ka qenë edhe në legjislaturën e kaluar. Përfaqësimi në këtë komitet do t ‘bëhet nga Kuvendi i Komunës dhe nga Shoqëria Civile. A jeni të pajtimit që përfaqësimi me qenë 2 me 3 në favor të Shoqërisë Civile apo 3 me 2 në favor të Kuvendit.

**z. Nexhat Loku,** Unë mendoj që përfaqësimi në këtë komitet të jetë: 3 nga Kuvendi i Komunës dhe 2 anëtarë nga Shoqëria Civile.

Propozimin e Nexhat Loku që përfaqësimi të jetë 3 me 2 në favor të KK e përkrahën edhe përfaqësuesit e dy subjekteve politike; LVV, Ekrem Kyçyku dhe LDK, Selim Reka

**Kryesuesi i Kuvendit,** Pasi u kuptuam për përfaqësimin, dihet se nga Kuvendi i Komunës, ky Komitet përfaqësohet nga tri subjektet politike me të mëdha, atëherë shkojmë me propozime konkrete nga tri subjektet politike që do të përfaqësohen (PDK, LVV dhe LDK).

**z. Nexhat Loku,** E propozoj për anëtarë në Komitetin për Komunitete, të jetë, Lirije Luta.

**z. Ekrem Kyçyku,** E propozoj, për anëtarë, në Komitetin për Komunitete, të jetë, Kaltrina Tafili.

**z. Selim Reka,** Propozoj për anëtarë në Komitetin për Komunitete të jetë, Nazife Krasniqi.

**z. Shpend Krusha,** Kërkoj të dijë për përfaqësimin nga Shoqëria Civile, kush e bënë propozimin, ndërkaq theksoj se “Shoqëri Civile” është term shumë i gjërë.

**z. Ekrem Raka,** Unë pa i pasur propozimet edhe për anëtarë nga Shoqërisë Civile, nuk do të votoj këtë komitet.

**Kryetari i Komunës, Besim Ilazi,** Nga Shoqëria Civile- OJQ, në Komitetin për Komunitete, propozoj për anëtarë; 1. Elmihane Krasniqi-Malsiu nga HANDIKOS dhe 2. Shemsedin Abazi nga KLDMNJ.

Propozimet që dolën, u shtruan në votim dhe të njëjtit u aprovuan njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për formimin e Komiteti për Komunitete, në përbërje, 5 anëtarë, dhe atë:**

- |                             |              |            |
|-----------------------------|--------------|------------|
| 1. Lirije Luta,             | nga PDK      | anëtar,    |
| 2. Kaltrina Tafili          | nga LVV      | anëtar,    |
| 3. Nazife Krasniqi          | nga LDK      | anëtar,    |
| 4. Shemsedin Abazi          | nga KDMLNJ   | anëtar dhe |
| 5. Elmihane Krasniqi-Malsiu | nga HANDIKOS | anëtar.    |

Kryesuesi i këtij komiteti zgjidhet nga radhët e anëtarëve.

**5. Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2018;**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyqyku,** Ky Plan pune, të pjesa e DUKMM, nuk jep asgjë, pos punëve rutinë të drejtorisë. Do pajtohem me këtë plan nëse do të ishte ndonjë projekt konkret, e jo të përfshihen projektet në total, si; "Hartimi i projekteve të ndryshme për rregullimin e qytetit" nuk dihet sa projekte janë dhe kostoj, etj. Në të njëjtin plan të kësaj drejtorie është paraqitur edhe, Plani i inspektorit të ndërtimeve, ku potencohe, ndalimi i ndërtimeve pa leje, si dhe inspektimi i atyre që janë pajisë me leje ndërtimore.

Puna e inspektimit duhet të jetë e ndarë, nga sektori apo nga drejtoria, sepse kjo paraqet konflikt interesit. Nuk duhet i njëjti sektor që lëshon leje ndërtimi, të bëjë edhe inspektimin, ose i njëjti sektor që e ndalon ndërtimin pa leje, të udhëzoj palën që të shkoi përsëri t'i njëjti sektor për leje ndërtimi.

Në pjesën e planifikimit urban dhe hapësinor shënohet se qeveria komunale paska në plan të inicioj, Rishikimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Komunal Urban për zonën 1, dhe të njëjtën kohë parashev diskutim publik për Hartën Zonale.

Këtu bënë të kuptohet se, Harta Zonale nuk ka filluar, ose do të filloj së shpejti, ose ka filluar të hartohet dhe është në procedurën e debatit publik me qytetarë,

Dua t'i përkujtoj se për cilin do ndryshim, Planet Zhvillimore të Komunës duhet të votohet në Kuvendin e Komunës, të hartohet nga drejtoria e cila dihet t'i zhvilloj procedurat e debatit publik me qytetarë, të harmonizohet dhe tërë kjo procedurë shkon 1 vit, ndërkëq me ligj jemi të obliguar të fillojmë punën në harta zonale, ku me këtë dokument do të evitohen shumë probleme. Nuk mundet zhvillimi urban të zgjidhet pjesë-pjesë.

**znj. Kaltrina Tafili,** Të Plani i punës së ekzekutivit, unë i kam shqyrtauar planet e punës së ekzekutivit për katër vitet e fundit dhe kam vërejtur se në fusha të caktuara si, ta zëmë Arsimi, thuhet se do përmirësojmë cilësinë e arsimit; apo do e rrisim disiplinën, e të kështu të ngjashme, dhe kështu po thuhet edhe këtu në këtë Plan, ndërsa ne kemi vërejtur, (edhe unë si pedagoge me profesion) se cilësia dhe gjendja në arsim jo vetëm që nuk është përmirësuar por madje të dhënat flasin se ajo është degraduar akoma më shumë.

Çka do të bëni konkretisht në mënyrë që ta përmirësoni gjendjen, ngase me fraza të përgjithshme sikundër janë shkruar këtu nuk mund të përmirësohet gjendja? Pra duhet të ketë më tepër detalizime në mënyrë që të jeni më konkret.

Me qenë se në përgjithësi ky Plan i punës së qeverisë komunale duke qenë i ndryshëm ndaj projektit tonë qeverisës me të cilin kemi garuar edhe në zgjedhjet e fundit komunale dhe si i tillë nuk paraqet përbushje të ideve tona, atëherë do e votojmë Kundër.

**znj. Fatijona Kyçyku,** Tek pika për renovimin e objekteve shkollore, më konkretisht çka do të rinovalohet pasi që e dimë që shumë shkolla kanë nevojë për renovim, por përparësi duhet t'i jepet shkollës së Mesme Profesionale “ Feriz Guri dhe Vellezërit Çaka” pasi që është në gjendje të mjerueshme dhe nuk ka hapësira të mjaftueshme për mësim.

**z. Selim Reka,** Plani i punës së ekzekutivit të komunës për vitin 2018 është shumë i gjerë, nuk është konkretizuar me plane konkrete dhe plane investuese. Se paku 50% e projekteve të parapara në këtë plan, uroj të mos na përsëritën në Planin e ekzekutivit të komunës të vitit 2019.

**znj. Nazife Krasniqi,** Mendoj se në këtë Plan pune, të sektori i Shëndetësisë, duhet të përfshihet; Furnizimi me barna esenciale i QKMF, sepse në këtë drejtim ka pasur ngecje, si dhe të gjenden forma përritjen e stafit mjekësor, si; gjinekolog etj. premtim ky i cili është dhënë në mandatin e kaluar se do të realizohet.

Të vendosja e shenjave të komunikacionit, Kërkoj nga sektori përkatës të merr veprime të nevojshme për vendosjen e një, Laure, në vendkalimin afër lagjes “Dushkaja” sepse ky vendkalim paraqet rrezik për nxënësit dhe qytetarët të tjerë të cilët kalojnë atypari.

**Kryetari i Komunës,** Kur po e hartojmë planin në formë të shkurtuar ka pasur kritika, ngjashëm është edhe kur planin e kemi hartuar në formë të zgjeruar. Nuk do të thotë se ky Plan nuk ka vërejtje, por plani duhet me harmonizuar edhe me buxhetin. Në vazhdim Kryetari sqaroj për çështjen e barnave esenciale, rritjen e numrit të mjekëve specialist, me çka theksoj se kemi shpall, Konkurs për mjek- gjinekolog, por nuk ka pasur të interesuar.

**z. Zahir Doda,** Unë jam në fillim, por do të angazhohem që arritjet t'i shohim dhe prekim në sektorin e arsimit. Çështjet të cilat mund t'i premtoj:

- T'i bëjë funksionale, Këshillat e shkollave,
- Për orët e humbura, të mbahet evidencë dhe do të marrë veprime për heqjen e mëditjeve,
- Me subvencionet të cilat i ka ky sektor, do të mundohem t'i orientoj në nevoja me prioritet.
- Prioritet, Ndërtimin e Shkollës së Mesme Profesionale “ Feriz Guri dhe Vellezërit Çaka” e cila ka mbetur në gjysmë. Këtë projekt u premtoj se do ta përmbylli deri në fund të mandatit tim. Për këtë projekt e kam përkrahjen edhe të Kryetarit të Komunës.

**z. Ramadush Osmani,** Sa i përket vendosjes së, Laurës të vendkalimi i Hekurudhës, është e vërtetë se ajo pjesë është keq dhe paraqet rrezik për kalimtarët. Ne jemi në kontakt me zyrtarët e Hekurudhës, sepse për me marrë veprime në këtë rast, është në kompetencë të Hekurudhës. Ne do t'i bëjmë, Kërkesë Hekurudhës, por kujtoj se një hap i tillë i tejkalon kompetencat tona.

**z. Bekim Koxha,** Rruga të Fusha e Pajtimit është në gjendje të rëndë, me çka paraqet rrezik për nxënës dhe kalimtarë të tjerë. Unë kërkoj nga dikasteri përkatës me marrë veprime të nevojshme për me bërë një zgjidhje në atë pjesë.

Lidhur me Kërkesën e z. Bekim Koxha u pajtua edhe drejtori i DAK, Zahir Doda, i cili theksoj se vendkalimi të Fusha e Pajtimit është e vërtetë se paraqet rrezik për nxënësit e shkollës dhe kalimtarët tjerë të rastit.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Kjo Kërkesë ka pasur mundësi me u parashtrua të pozicioni: Pyetjet dhe Kërkesat, por mundeni me iu drejtua me shkrim edhe drejtorisë përkatëse.

**z. Bekim Koxha**, Unë kam shqetësim për mbylljen e rrugës nga kompania” Bektel Enka”, dhe nuk po merren kurrfarë veprimesh ndaj saj, për me bërë përgjegjëse këtë kompani.

**Kryetari i Komunës**, Shqetësimin tuaj z. Koxha e kemi përcjellë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe presim përgjigje nga ky dikaster.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Meqë nuk pati kush diçka tjeter, atëherë Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2018, u shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua me 17 votë Për, Kundër ishin 9 anëtarë, Abstenoj 1 anëtar. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës, mori këtë:

#### VENDIM

#### **Me të cilin e Aprovoj, Planin e Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2018.**

6. Propozim Vendimi për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);

**Kryesuesi i Kuvendit**, Sqarime të nevojshme në këtë Propozim Vendim dha Kryetari i Komunës Besim Ilazi,

**Kryetari i Komunës**, Kështu ka qenë formati në Legjislaturën e kaluar dhe vendimi nuk na është kthyer nga MAPL. Sa i përket emrave, ne nuk mund të shkojmë me emra konkret, sepse nëse ndërrohet një anëtar, fjala vjen nëse ndërrohet një drejtor i drejtorisë, atëherë duhet me intervenuar të ai përfaqësues, ndërkaq ndryshimet dihet se bëhen nga Kuvendi i Komunës.

**z. Adnan Reka**, Propozim Vendimi për formimin e KKSB-së, nuk është në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, në bazë të UA Nr. 27/2012 të MPB, dhe 03/2012 të MAPL, Të pika, 1.14 e nenit 4, të përfaqësimi i KKSB; përfaqësimi i OJQ, mediat lokale, komuniteti i biznesit dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara, duhet të përfshihen me një përfaqësues. Numri i përgjithshëm i këtij Këshilli nuk mund të jetë më i lartë se 14 anëtarë. Emrat e anëtarëve të këtij Këshilli duhet të janë të njojur paraprakisht për anëtarët e Kuvendit, me përjashtim të emrave që janë të njojur për ne, si Kryetari i Komunës, Komandanti i Policisë, drejtori i DAK etj. me qëllim që të dihet paraprakisht se kush janë ata persona qe do të përfshihen në këtë Këshill. (të dihet e kaluara kriminale e personave të panjohur). Ne kërkojmë që ky propozim të ndryshohet, të jetë në përputhje me ligjin dhe sipas vërejtjeve tonë, që të mund të aprovohet nga ne.

**z. Ekrem Raka**, Të përfaqësimi i OJQ, sipas Udhëzimi Administrativ për formimin e KKSB, duhet me qenë një përfaqësues i të gjithave OJQ. Unë nuk do ta votoj këtë Propozim Vendim kështu siç është me akronime, ndërkaq me qëllim që i njëjti të plotësohet me emrat e anëtarëve përfaqësues të KKSB, propozoj që kjo çështje të shtyhet për mbledhjen vijuese.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Të përfaqësimi i OJQ, për ne është më mirë me qenë vetëm një përfaqësues, sepse kjo ndikon edhe në uljen e shpenzimeve për mëditje, mirëpo ne do ta shikojmë edhe një herë UA që e rregullon këtë çështje. Propozimin e z. Ekrem Raka me e

shtyrë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

### Vendosi

**Që Propozim Vendimi për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), të shtyhet për mbledhjen vijuese të KK.**

7. Propozim Vendimi për lejimin e mjeteve financiare, për realizimin e projekteve të Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Për këtë pikë për sqarime të nevojshme fjalën ia jap drejtorit të DAK, Zahir Doda për të dhënë sqarime të nevojshme në këtë Propozim Vendim.

**z. Zahir Doda,** Unë fillimisht kërkoj falje për standardin e përcjellë, ku janë specifikuar projektet, unë jam për herë të parë sa e kam marrë detyrën, dhe ky standard në të ardhmen nuk do të përsëritet.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse ka kush diçka në këtë pikë, e hapi diskutimin:

**znj. Nazife Krasniqi,** Të shpërndarja e mjeteve buxhetore, të Festa e Ditës së mësuesit, 7 Marsit dhe Ditës së Gruas, 8 Marsi, kujtoj se janë paraparë pak mjetet, vetëm 50 € për këto festa.

**Kryetari i Komunës,** Festat Dita e Mësuesit dhe Dita e Gruas, janë festa simbolike, mjetet e parapara nuk do të shpenzohen, sepse lulet etj. krejt kontraktohen, ndërkaq mjetet janë vetëm sa për t ‘paraparë mjete për këto festa, se ndoshta as këto mjete nuk do të shpenzohen.

**z. Adnan Reka,** Ky Propozim Vendim ka paqartësi dhe mungesë informacioni në shpërndarjen e mjeteve financiare, si fjalë vjen tek, Olimpiada Matematike e Kosovës; Ushqim dhe pije për nxënës 12 shumëzuar për  $1.5\text{€} = 18\text{€}$ , që është në rregull, por Transport i nxënësve, 12 shumëzuar me  $20\text{€} = 240\text{€}$ , nuk është në rregull, kur dihet fakti se me nga  $10\text{€}$  mund t’i dërgoni edhe në Durrës nxënësit. Të Gjuhëtari ri 2014; Ushqim dhe pije për nxënës, 35 shumëzuar  $1.5\text{€} = 52.50\text{€}$ , Transport i nxënësve 12 shumëzuar me  $10\text{€} = 120.00\text{€}$ , Ushqim 35 nxënës. transport 12 nxënës nuk përputhet numri i nxënësve Testi arritshme-risë për klasat IX-ta dhe testi maturës 2014; Ushqim dhe pije për administruesit e testit,  $450\text{€}$ , në rregull!, ndërkaq për, Pije për nxënësit (Ujë) =  $900\text{€}$ , është pak sa e tepërt, numri i përgjithshëm i nxënësve. që marrin pjesë në testin e arritshme-risë dhe të maturës është **1066**. Po t’i përpjesëtojmë këto shifra, del se një nxënës do të pijë ujë në vlerë prej  $0.82$  cent, që është e barabartë me 4 apo 5 shishe ujë. Udhëtime të ndryshme =  $1,000.00$  nuk janë specifikuar për kënd janë këto udhëtime.

Të Transporti i nxënësve: Pagesa e transportit të nxënësve me nevoja speciale Kaçanik;  $2,700.00$ ; Subvencione për nxënës me nevoja speciale për raste,  $1,950.00$ ; Pagesa e transportit të nxënësve te shkollave fillore të  $9,435.50$  (Mungesë e qëllimshme e informacionit); Pagesa e transportit të nxënësve të shkollave të mesme të ...  $20,000.00$  nuk është specifikuar.; Transporte tjera të nxënësve,  $500.00$  (cila është arsyja). Totali,  $34.585.50$  (duhet të jenë të specifikuara). Të shuma,  $10,000.00$ , Bursa për studentë, sa është numri i studentëve përfitues dhe sa është shuma për një bursë.

**z. Nexhat Loku,** Të transporti i nxënësve kjo është e qartë, sepse dihet se për cilët nxënës bëhet transporti, ndërkaq të çështja e bursave, kjo bëhet nga një komision.

**z. Adnan Reka,** Çështja është se, ne nuk i kemi të gjitha informata lidhur me këtë Plan, ndërkaq për ju ndoshta janë të ditura.

**z. Zahir Doda,** Theksoj se për realizimin e projekteve të sektorit të Arsimit, në vitin 2018 janë paraparë 48.190.oo€, ndërkaq për ato të, sektorit të Kulturës, 47.000.oo€. Shpërndarja do të bëhet ashtu siç është specifikuar në Planin e shpenzimeve buxhetore të DAK. Në vazhdim drejtori sqaroj shpërndarjen e mjeteve për projektet; transport dhe ushqim të nxënësve, Olimpiadë, numrin e nxënësve, ndërkaq shtoj se 318 € kujtoj se nuk janë shumë për gara në nivel shtetëror. Të testi i arritshme-risë, nuk jam pajtuar as unë. Për Klasat e 9-ta, nëse ndodhë testi ditëve të shtunave, se paku duhet me iu dhanë ushqim. Në vazhdim drejtori Doda, sqaroj për transportin e nxënësve me nevoja të veçanta, ndërkaq shtoj se ka nxënës nga kjo kategori që barten për Prishtinë apo në Prizren.

Tjetër, disa shkolla nuk funksionojnë për shkak të numrit të vogël të nxënësve, dhe nxënësitet bartën në shkolla tjera, 20.000.oo€ janë për transport të nxënësve të shkollave të mesme. Për vitin vijues jam që të ulët kjo shumë për 10.000.oo€. Drejtori dha sqarime edhe për mjetet për bursa.

**z. Adnan Reka,** Duke u nisur nga arsyet që ti theksova, ne subjekti politik i LVV do të jemi kundër aprovimit të këtij Propozim Vendimi.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Meqë nuk ka diskutime të tjera, atëherë kjo çështje u shtrua në votim për aprovim dhe e njëjtë u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 9 anëtarë Abstenoj Ekrem Raka. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### **VENDIM**

**Për lejimin e mjeteve financiare për realizimin e projekteve të DAK, të parapara me buxhetin e vitit 2018, shuma 48.190.oo€ për realizimin e projekteve të Arsimit dhe shuma 47.000.oo€ për realizimin e projekteve të Kulturës.**

**8.** Propozim Vendimi për lejimin e mjeteve financiare, për realizimin e projekteve të Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Për këtë pikë fjalën ia jap drejtorit të DBPZH, Fatmir Loku.

**z. Fatmir Loku,** Sqaroj se buxheti i aprovuar për subvencione dhe transfere për DBPZHR për vitin 2018 është në shumë 60.000.oo€, ndërkaq do të mbështetën këto projekte: koshere bletësh me 15.000.oo€, Sera në sipërfaqe 50m<sup>2</sup> 25.000.oo € dhe 20.000.oo€ farë gruri dhe pleh mineral.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse ka kush diçka në këtë pikë u hap diskutimin:

**z. Selim Reka,** Mjetet për subvencione në këtë sektor janë pak karshi nevojave, ndërkaq për me qenë me konkret, në fund me u bërë një, Raport se ku janë ndarë mjetet, të bëhen Lista e përfitueseve dhe sa ka qenë efekti i tyre, në mënyrë që me shikuar mundësinë në të ardhmen për shtimin e tyre.

**z. Adnan Reka,** Për me qenë me i qartë ky Propozim Vendim është dashur të specifikohen projektet që do të subvencionohen, si fjala vjen sa bletarë do të subvencionohen me koshere të bletëve me shumën 15.000.oo€ e kështu me radhë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Nuk munden me u përcaktua çështja e projekteve që do të subvencionohen si koshere bletëve etj. sepse këto shkojnë përmes procedurës së tenderimit.

**z. Bekim Koxha**, Unë mendoj se shuma për subvencionimin e projekteve në bujqësi është e vogël, ndërkaq nuk dihet se kush përfiton nga këtë subvencione.

Meqë nuk pati diskutime të tjera, atëherë kjo çështje u shtrua në votim për aprovim dhe e njëjtë u aprovua me shumicën e votave PËR, Kundër votë nuk pati. Abstenoj, Ekrem Raka. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për lejimin e mjeteve financiare në shumë 60,000.oo€ (gjashtëdhjetëmijë euro) për realizimin e projekteve të Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të parapara me buxhetin e vitit 2018.**

9. Informatë e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor, 2017/2018;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Për këtë pikë fjalën ia jap drejtorit të DAK, Zahir Doda.

**z. Zahir Doda**, Informata është e hartuar mirë, përmban të dhëna të plota, edhe pse nuk është pjesë e punës sime, pak a shumë e di gjendjen në arsim.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Adnan Reka**, Në informatën e DAK thuhet se: Pjesë e përgatitjeve për Vitin e ri shkollor kanë qenë edhe trajnimet e mësimdhënësve për zbatimin e Kornizës së Kurikulë, por nuk përmendet, niveli i ulët i organizimit të këtij trajnimi, duke marrë për bazë rëndësinë e tij, siç ishte (zbatimi i dokumentit më të rëndësishëm në nivel të shtetit, në fushën e arsimit). Trajnimi ishte përcjellë nga disa parregullsi, si; vonesa e fillimit të trajnimit, angazhimi i trajnerëve nga komunat tjera (duke pasur mundësinë që të gjithë trajnerët të ishin nga Komuna jonë), mungesa të materialit për trajnim si projektorët, laptopët etj., si dhe mungesa e ujit të pijshëm për mësimdhënësit në atë ditë të nxeh të muajit qershori.

Informacioni thotë se janë përzgjedhur dhe instaluar koordinatorët e cilësisë, në të gjitha shkollat. Ne themi se informacioni nuk është i saktë, sepse ende ka shkolla ku nuk janë përzgjedhur koordinatorët e cilësisë.

Më tej informacioni, furnizimi me tekste mësimore i shkollave nga MASHT për nxënës nga 1-5, për çfarë unë mund të konfirmoj se jo të gjithë nxënësit nga 1-5 i kanë përfituar të gjitha librat. Të informacioni, fillimi i ndërtimit të objekteve shkollore, në Kaçanik të Vjetër, Glloboçicë dhe Kovaçec, nuk përmendet shkolla në Kovaçec e cila ende pa u ndërtuar ka filluar të shkatërrohet. Shkolla në ndërtim e sipër, tanë është një vend i rrezikshëm për nxënësit e shkollës, ku nuk përfillet asnjë kriter i sigurisë. I gjithë materiali ndërtimor është i shpërndarë në afërsi të shkollës ku mbahet mësimi dhe nuk është e rethuar me asnjë rrethojë mbrojtëse për të penguar qasjen e fëmijëve në vend-punishte. Të dhënat e këtij informacioni lënë mjaftë për t'u dëshiruar, shpresojmë që Drejtori i ri i arsimit të jetë më efikas dhe dokumentacionet e shkruara në letër të bëhen realitet për qytetarët e Komunës sonë. Me intereson të di se do të mund të kemi Këshilla Drejtues funksional në të gjitha shkollat?

**znj. Arlinda Rakoci-Raka,** Në shkollat e komunës së Kaçanikut, dihetështë i vogël numri i pedagogëve dhe psikologëve të punësuar, ndërkaq shtimi i numrit të tyre është e nevojshme dhe domosdoshme për evitimin e disa nga problemet në arsim, e që evitimi i problemeve të tillë, ndikon në ngritjen e cilësisë në arsim.

**znj. Nazife Krasniqi,** në F. 4 të materialit, Komisioni për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, me intereson të di kush ka qenë në këtë komision që ka bërë një vlerësim të tillë.

**z. Ekrem Raka,** Në dy shkollat e mesme shihet se suksesi ka dal pozitiv me 43,6%, ndërkaq për mendimin tim sukseset arrihen nëse në fund të vitit rritet cilësia e mësimdhënies dhe mësim-nxënies.

Çështje tjetër, Sipas LVL, është obligim i Kryetarit të Komunës me e njoftuar Kuvendin e Komunës për emërimin e drejtoreve të drejtoreve komunale.

**z. Shpend Krusha,** E përgëzoj drejtorin e DAK, për këtë informatë, ndërkaq me intereson të di, a parashihet kamerat e sigurisë në shkolla.

**z. Selim Reka,** Numri i madh i mungesave; nxënësve dhe i arsimtarëve është për shkak të ekskursionit të nxënësve në Shqipëri dhe të trajnimeve të arsimtarëve. Në këtë aspekt duhet DAK në bashkëpunim me shkollat me filluar me e modifikuar Rregulloren e punës që të dimë për masat që duhet merren për mungesat pa arsyetë nxënësve dhe të arsimtarëve.

Duhet të krijojmë kushte për rritjen e cilësisë në arsim, ashtu siç e potencoj znj. Raka me pasur psikolog dhe pedagog në shkolla. Mendoj se duhet mbahen takime të përbashkëta e Kryetarit të Komunës, drejtorit të DAK, drejtorët e shkollave dhe përgjegjësitë të tjera, për tejkalimin e vështirësive në arsim.

**z. Zahir Doda,** Unë do të bëjë verifikim lidhur me mungesat pa arsyetë dhe do të marrë masa sankzionuese me ndaljen e mëditjes. Trajnine e di se janë mbajtur, ndërkaq nivelin e tyre nuk e di. Të shkolla filllore në f. Kovaçec, unë nuk kam qenë në vendngjarje, mund të jetë ashtu, ndërkaq kritikat e juaja i marrë për bazë sepse të njëjta me shërbejnë për të ardhmen. Të Çerdhja e Fëmijëve, gjendja është e rëndë, ndonjë premtim për momentin nuk kam. Nëse ka kush ndonjë ide, do ta diskutojmë.

Komisioni për fëmijët me nevoja të veçanta, është më UA i përcaktuar dhe i njëjti ka funksionuar. Të mungesat, kujtoj se do të reduktohen, nëse janë funksional Këshillat e shkollave.

**z. Shpend Krusha,** Të çështja e Sigurisë në shkolla, mos të keqkuptohem, unë e kam fjalën me tepër për njerëzit që janë jashtë shkollës.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Meqë nuk ka kush diçka tjetër, Informata dihet se nuk del në votim, ndërkaq konstatoj se Kuvendi i Komunës, u Informua me aktivitetin e përgjithshëm të arsimit; të arriturat dhe sfidat që e kanë përcjellë sektorin e arsimit për gjatë gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor 2017/2018 përmes, Informatës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës.

**10. Informatë për përformancën e Komunës për vitin 2016;**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Për me dhënë sqarime të nevojshme në Përformancën e Komunës;

**Kryetari i Komunës -Besim Ilazi,** Theksoj se si komunë jemi në një mesatare në aspektin e përformancës në raport me komunat tjera. Tani me këtë dokument, I herë në vit njoftohet KK nga 1-15 janar. Duhet shikuar tani e tutje çka duhet të bëjmë si komunë që kjo përformance të rritet. Vlerësimet e aktivitetit të komunës bëhen në të gjithë sektorët dhe kur të mblidhen të gjitha, atëherë del rezultati i përformancës.

**z. Adnan Reka,** Është e vërtetë se Komuna e Kaçanikut bënë pjesë në nivelin e Komunave me madhësi mesatare (prej 31.000 banorë – 59.000 banorë) dhe ka arritur përfomancë të shkallës së mesme (51.29%) më e ulët se mesatarja e vendit për 7.39% (e cila është 58.68%), ndërkaq askund ky raport nuk tregon se nga 38 Komuna të Kosovës sa janë gjithsej, Kaçaniku renditet në vendin e 35, ndërkaq mbetet në pozitën e parafundit me përjashtim të komunës së Kamenicës e cila është e fundit, Kaçaniku mbrapa ka edhe Kllokotin dhe Mamushën (Komuna të vogla), për çfarë unë nuk e di a do të duhej të ndjehej rehat, në çfarë niveli të krahasimit është!

Thënë ndryshe, ndonëse Kaçaniku e kalon klasën (d.m.th. mbi 50 %), Kaçaniku e kalon klasën me notën 2-sh.

Në raport thuhet se, Komuna jonë qëndron shumë mirë në fushën e ofrimit të shërbimeve publike administrative (99.47%) por Raporti i Përfomancës së Komunave të MAPL thotë së në Komunën tonë, 1 zyrtar u shërben (30.57) gati 31 qytetarëve, ndërsa standardi është, 1 zyrtar t'u shërbej 40 qytetarëve, ndërsa kemi komuna që u shërbejnë 57.83 (Prizren), 60.53(Mitrovica) (edhe një herë më shumë se Komuna jonë. Kjo të bënë me kuptuar se komuna e jonë me mbingarkesë të punëtorëve të punësuar në administratë, e shpenzon buxhetin për paga dhe mëditje “e mbijetesës” prej afro 6 milion eurove, e normalisht që shumë pak mbetet për investime kapitale

Kjo të bënë me kuptuar se komuna e jonë me mbingarkesë të punëtorëve të punësuar në administratë, e shpenzon buxhetin për paga dhe mëditje “e mbijetesës” prej afro 6 milion eurove, e normalisht që shumë pak mbetet për investime kapitale.

**z. Ekrem Raka,** Mua me brengosë fakti ku thuhet se komuna ka përfomancë të dobët në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, ndërkaq të infrastruktura rrugore, dihet se rrugë janë shtruar mjaft, ndërkaq përfomanca është e ulët.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë, Konstatoj se Kuvendi i Komunës, **u Informua me, Përfomancën e Komunës së Kaçanikut për vitin 2016.**

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu Kryesuesi i Kuvendit në ora: 13:07 e konstatoj mbledhjen të përfunduar.

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu  
*Makfire Malsiu*



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mërseli

**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS  
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 207);**

**nga Mbledhja e I (Parë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2018, mbajtur me 24 Janar 2018.**


1. Kemal Mërseli
2. Hamid Guri.....,.....,
3. Ahmet Luma .....,.....,
4. Kadri Krivenjeva,.....,.....,
5. Besim Vishi,.....,.....,
6. Sali Malsiu.....,.....,
7. Lirije Shurdhani.....,.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,.....,
9. Lirije Luta.....,.....,
10. Vlora Dalloshi.....,.....,
11. Nexhat Loku .....,.....,
12. Shpend Krusha.....,.....,
13. Adnan Reka.....,.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,.....,
16. Kaltrina Tafili .....,.....,
17. Selim Reka.....,.....,
18. Besnik Salihu,.....,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,.....,
21. Shemsedin Luzha.....,.....,
22. Albana Troni.....,.....,
23. Afërdita Shehi,.....,.....,
24. Hajredin Luta.....,.....,
25. Hafize Sallahi .....,.....,
26. Bekim Koxha.....,.....,
27. Ekrem Raka,.....,.....,



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik



PËR: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal,  
-Zyrës Ligjore-  
NGA: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Kaçanik, Kemal Mërseli

Lënda: Dërgimi i Vendimeve të mbledhjes së I (Parë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, mbajtur me 24 Janar 2018.

Bashkëlidhur me këtë Shkresë, u dërgojmë, Vendimet e Kuvendit të Komunës Kaçanik, nga mbledhja e I (Parë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë : 24 Janar 2018, dhe atë:

1. Vendimi për aprosimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2018 / Lënda: 01Nr. 104/02-1881/2018;
2. Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa/ Lënda; 01 Nr. 60/01-1785/2018;
3. Vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete / Lënda: 01Nr. 60/01-1787/2018;
4. Vendimi për aprosimin e Planit të Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2018 / Lënda: 01Nr. 60/01-1839/2018;
5. Vendimi për lejimin e mjeteve financiare, për realizimin e projekteve të Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës / Lënda: 01Nr. Nr.400/01-1823/18;
6. Vendimi për lejimin e mjeteve financiare, për realizimin e projekteve të Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural / Lënda: 01Nr. 08-400/01-1466/18.

Vendimet ua dërgojmë në afatin e përcaktuar ligjor, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre nga Zyra Ligjore e MAPI-së.

Me respekt!

